



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 19 Shkurt 2022

Nr: 91

VENDIM

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 12 DATË 26.01.2022, TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE, “PËR MIRATIMIN E MATERIALEVE ZGJEDHORE QË DO TË PËRDOREN PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE PËR DISA NJËSI TË QEVERISJES VENDORE TË DATËS 6 MARS 2022”

Në mbështetje të Dekretit nr. 13438, datë 20.01.2022 të Presidentit të Republikës “Për caktimin e datës së Zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 99, pikat 1 e 2, nenit 100, pika 1, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” e “d” dhe nenit 104, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I:

1. Nënndarja “ii”, e shkronjës “a”, të pikës 1 të vendimit nr. 12, datë 26.1.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ndryshohet si më poshtë vijon:
“ii. Kodet e sigurisë dhe kodet rezervë për mbylljen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore, sipas modelit të miratuara me vendim nr. 35, datë 16.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për Miratimin e Modelit dhe Specifikimeve të Vulave me Kod Sigurie, që do të përdoren për Zgjedhjet për Kuvend datë 25 Prill 2021.”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 19 Shkurt 2022

Nr. 91

“Për një ndryshim në vendimin nr. 12, datë 26.1.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e materialeve zgjedhore që do të përdoren për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore të datës 6 Mars 2022”